



**Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo**  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

## **KUVENDI**

Në bazë të nenit 12.2 shkronja d të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/ L - 040, nenit 4 paragrafi 3 të Ligjit për Teatrot nr. 04/L-106 dhe 15.2 shkronja d të Statutit të Komunës, nr. 01-1/298-10, Kuvendi i Komunës së Podujevës, në mbledhjen e mbajtur më 17 dhjetor 2012, mori:

## **VENDIM**

### **PËR THEMELIMIN E TEATRIT PUBLIK TË QYTETIT TË PODUJEVËS**

#### **NENI 1**

Themelohet Teatri Publik i qytetit të Podujevës.

#### **Neni 2**

Emërtimi i Teatrit është:  
Teatri i qytetit “ Avdush Hasani “ - Podujevë.

#### **Neni 3**

Teatri funksionon në cilësinë e institucionit publik dhe aktivitetet i zhvillon në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi.

#### **Neni 4**

Përbërja, organizimi i mbrendshëm, emërtimi, - të drejtat dhe përgjegjësit, logoja, vula, kontoja bankare dhe selia përcaktohen me Statutin e Teatrit.

#### **Neni 5**

Vendimi hyn në fuqi pas miratimit, përkatësisht 8 ditë pas vlerësimit të ligjshmërisë nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal.

**Nr. 01/239 - 640**  
**Podujevë,**  
**17 dhjetor 2012**

**Kryesuesi i Kuvendit**  
**Hazir Raçi**